

VENDIM
Nr. 414, datë 7.7.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 858, DATË 29.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 1, shkronja “e”, 19, pika 4, 21, pika 3, 23, pika 1, 29, pikat 1 e 6, 33, pika 6, 37, pikat 1 e 4, 56, pika 7, 81, pika 4, 84, pika 4, 91, pika 3, dhe 140, pika 1, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun II bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të fjalisë së dytë, të pikës 4, të nënndarjes “B”, shtohen fjalët “... ku t’i bashkëlidhet certifikata e lindjes në gjuhën shqipe ose anglisht, ose dy kopjet e pasaportës së të dy prindërve.”.

b) Në nënndarjen “C” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i. Pas shkronjës “a”, të pikës 1, shtohet shkronja “b”, me këtë përmbajtje:

“b) biletën e udhëtimit drejt vendit të destinacionit.”.

ii. Pas shkronjës “b”, të pikës 2.1, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) Listën emërore të grupit të organizuar turistik së bashku me itinerarin e udhëtimit dhe akomodimit për ditët e qëndrimit në territor.”.

iii. Në shkronjën “b”, të pikës 3.1, përmasat “5cm x 4cm” zëvendësohen me “47 mm x 36 mm.”.

iv. Në shkronjën “d”, të pikës 3.1, pas emërimit “Republikës së Shqipërisë” shtohen fjalët “... me përjashtim të punonjësve lëvizës digjitalë, për të cilët do të pranohet vetëdeklarim mbi ekzistencën e dokumenteve që provojnë akomodimin e përshtatshëm në Shqipëri, sipas aneksit nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

v. Në shkronjën “a”, të pikës 3.17, togfjalëshi “Kontratë e vlefshme” zëvendësohet me fjalët “... vetëdeklarim mbi një kontratë të vlefshme, sipas aneksit nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi ...”.

vi. Pas shkronjës “a”, të pikës 3.17, shtohet shkronja “b”, me këtë përmbajtje:

“b) Vetëdeklarim mbi ekzistencën e dokumenteve që provojnë akomodim të përshtatshëm në Shqipëri, në përputhje me standardet e banimit në Shqipëri, sipas aneksit nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi ...”.

2. Në kreun III bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në nënndarjen “A” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Në pikën 10, pas emërimit “Republikën e Shqipërisë” shtohen fjalët “... me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë vendim ...”.

ii. Pas pikës 12 shtohet pika 13, me këtë përmbajtje:

“13. I huaji, që pajiset me leje unike për raste të veçanta në zbatim të nenit 81, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, depoziton kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues për lëshimin e lejes unike për raste të veçanta pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin.”.

b) Në nënndarjen “B” bëhen shtesat e mëposhtme:

i. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Vetëdeklarim mbi ekzistencën e dokumenteve që provojnë akomodim të përshtatshëm në Shqipëri, sipas aneksit nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në përputhje me standardet e banimit në Shqipëri, vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht në këtë vendim.”.

ii. Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Pas miratimit të lejes unike, i huaji, që ka aplikuar me vetëdeklarim, sipas parashikimeve të kreut III, nënndarja “D”, shkronja “g”, ka detyrimin, që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të depozitohet pranë strukturës përgjegjëse vendore për kufirin dokumentacionin origjinal provues.”.

c) Në nënndarjen “D” bëhen këto shtesa:

i. Pas nënparagrafit “ii”, të shkronjës “g”, shtohet nënparagrafi “iii”, me këtë përmbajtje:

“iii. Komisioni vlerësues për plotësimin e kushteve të lejes unike si të vetëpunësuar shqyrton dokumentacionin e mëposhtëm:

- Projektide për biznesin/aktivitetin (që pasqyron minimalisht elementet e rekomanduara nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive);

- Dokument që provon se ka mjete të mjaftueshme financiare, jo më pak se 500 000 (pesëqind mijë) lekë ose vlera ekuivalente me të në dollarë ose euro (vërtetim nga banka në Republikën e Shqipërisë ose në vendin e origjinës);

- Dokument që provon aftësitë e nevojshme (certifikatë/diplomë ose dokument të barasvlefshëm me të), ose licencë për ushtrimin e profesionit (sipas legjislacionit për profesionet e rregulluara);

- Certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.”.

ii. Në shkronjën “g” bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

ii/1. Në nënparagrafin “ii”, togfjalëshi “Kontratë e vlefshme” zëvendësohet me fjalët “... vetëdeklarim mbi një kontratë të vlefshme ...”.

ii/2. Nënparagrafi “iii” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“iii. Vetëdeklarim mbi disponimin e burimeve financiare të mjaftueshme për të mbajtur veten dhe personat në ngarkim gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, në vlerë jo më pak se 408 000 (katërqind e tetë mijë) lekë, sipas aneksit nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

ii/3. Pas nënparagrafit “iv” shtohet nënparagrafi “v”, me këtë përmbajtje:

“v. vetëdeklarim mbi ekzistencën e dokumenteve që provojnë akomodim të përshtatshëm në Shqipëri, në përputhje me standardet e banimit në Shqipëri, sipas aneksit nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

3. Në aneksin nr. 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në seksionin A, të nënpikës 1.4, pas fjalëve “ ... unë kam bashkëngjitur kontratën e qirasë/dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin/çdo dokument tjetër që provon akomodimin ...” shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Unë kam bashkëlidhur formularin e vetëdeklarimit për akomodim të përshtatshëm, në përputhje me standardet e banimit në Shqipëri.”.

b) Në seksionin B, të nënpikës 2.4, pas fjalëve “... fotokopje e kontratës së punësimit ...” shtohen “... formularin e vetëdeklarimit mbi një kontratë të vlefshme ...”.

4. Pas aneksit nr. 9, “Formularët standardë të aplikimit për lëshimin e lejeve të qëndrimit të kategorive: Për motive të bashkimit familjar, për motive arsimi, trajnimi, kërkimi shkencor, për raste humanitare, për qëndrim të përhershëm dhe për kategori të veçanta”, shtohet aneksi nr. 10 “Formular vetëdeklarimi për akomodim/burime financiare/kontratë e vlefshme.”.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ANEKS 10/ANNEX 10
FORMULAR VETËDEKLARIMI - SELF-DECLARATION FORM
Për akomodim/burime financiare/kontratë e vlefshme
On accommodation/ on financial means/ on a valid contract

TË DHËNAT E DEKLARUESIT/DECLARANT DATA	
Emri/First Name	
Mbiemri/Last name	
Data e lindjes/Date of birth	
Vendi i lindjes/Place of birth	
Shtetësia/Nationality	
Numri i kartës ID/Pasaportës/ID Card/Passport No.	

Në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 79, datë 24.6.2021, "Për të huajt" dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, "Për caktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, deklaroj se:

In compliance with the provisions of Law no. 79, dated 24.06.2021 "On foreigners" and with the Decision of the Council of Ministers no. 858, dated 29.12.2021 "On the setting of criteria, procedures and documentation for the entry, stay and treatment of foreigners in the Republic of Albania", amended, I declare that:

Kam siguruar akomodim të përshtatshëm për qëndrimin tim në Shqipëri, duke garantuar që do të kem një vend ku të qëndroj në çdo kohë dhe nuk do të ngelem pa strehë. <i>I have secured adequate accommodation for my stay in Albania, ensuring that I will have a place to stay at all times and will not be stranded without shelter.</i>	
Deklaroj se kam burime të mjaftueshme financiare për të mbajtur veten dhe personat në ngarkim, nëse do të kem, gjatë qëndrimit tim në Republikën e Shqipërisë. <i>I hereby declare that I have sufficient financial resources to support myself and my dependants, if any, during my stay in the Republic of Albania.</i>	
Kam lidhur një kontratë pune të vlefshme me punëdhënësin jashtë vendit ose një kontratë shërbimi me kontraktorin ose klientin jashtë vendit që ai/a jo do të punojë pa një seli të caktuar për punë specifike, e cila lejon punën përmes mjeteve të teknologjisë së komunikimit. <i>I entered into a valid employment contract, entered into with the employer abroad or a service contract with the contractor or the client abroad that she/he will work without a specific headquarters for specific work, which allows work through communication technology tools.</i>	

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe kuptoj se çdo deklaratë e rreme e dhënë në këtë formular mund të çojë në përjashtimin tim nga vendi dhe nga çdo procedim i mëtejshëm në lidhje me dhënien e lejes unike.

I declare that the data presented in this form are true and I understand that any false statement provided in this form may lead to my exclusion from the country and from any further proceedings in respect of the issuing of single permit.

DEKLARUESI/DECLARANT

(emri, mbiemri, nënshkrimi)
(name, last name, signature)
Data/Date ____/____/_____

Shënim. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave të parashikuara në këtë formular do të bëhet në përputhje të plotë me dispozitën e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Note: Storage and processing of the data provided in this form shall be done in full compliance with the provision of law no. 9887, dated 10.03.2008 “On the protection of personal data”, as amended.